

Besimtare? te? shumte? ne? Maqedoni Shqipe?ri dhe Kosove? kane? marre? pjese? ne? faljen e namazit te? Fite?r Bajramit ke?te? me?ngjes, raporton Anadolu Agency (AA).

Qindra mije?ra besimtare? I jane? drejtuar xhamive dhe shesheve pe?r tu be?re? pjese? e lutjeve dhe faljes se? namazit te? Fite?r Bajramit I cili e?shte? nje? nga festat me? te? me?dha te? fese? Islame.

Ashtu sikurse ne? shume? qytete te? Shqipe?rise? edhe ne? Tirane? mije?ra besimtare? i jane? drejtuar bulevardit "De?shmore?t e Kombit" pe?r te? falur ke?te? namaz, pas pe?rfundimit te? muajit te? shenjte? te? Ramazanit.

Besimtare?ve te? shumte? iu jane? bashkuar drejtues te? shumte? te? politike?s dhe institucioneve fetare, nde?rkohe? nje? nga imame?t e Meke?s, Shejh Salih Bin Talib, ka qene? i pranishe?m ne? faljen e namazit te? Bajramit.

Imami Shejh Salih Bin Talib, ka mbajtur edhe nje? ligje?rate? te? shkurte?r pe?r besimtare?t e pranishe?m ku mesazhet kryesore te? tij ishin pe?r bashkimin dhe unitetin. Ai ka theksuar ne? fjale?n e tij se feja Islame e?shte? fe e paqes dhe jo e dhune?s dhe terrorizmit.

Nde?rkohe? hutben e rastit e mbajti Myftiu i Tirane?s, Ylli Gurra.

Ne? organizimin te? Bashke?sise? Fetare Islame te? Maqedonise? ne? prani te? kreut te? saj, Sulejman Rexhepi dhe nje? numër te? madh te? besimtare?ve muslimane?, ne? xhamine? Mustafa Pasha ne? Shkup u mbajt manifestimi qendror i Fite?r Bajramit, ne? te? cilin u ke?ndua Kuran, ilahi dhe kaside ne? gjuhe? te? ndryshme te? komuniteteve qe? jetojne? ne? Republike?n e Maqedonise?.

Namazit te? Bajramit i priu myftiu i Tetove?s, Qani Nesimi, nde?rsa hutben e Bajramit ne? eme?r te? kreut te? BFI-se? Sulejman Rexhepi e lexoi nxe?ne?s i Medresese? Isa Beu ne? Shkup, Ajdan Jahja i cili tha mes tjerash se besimtare?t kane? pe?rcjell muajin e Ramazanit me dhembshuri sepse i nje?jti pe?r muslimane?t e ka kuptimin e kalimit nga erre?sira ne? drite?, muaji kur ka filluar shpallja e librit te? shenjte?.

Hytben e Fite?r Bajramit ne? xhamine? e Madhe ne? Prishtine? e ka mbajtur Myftiu i Kosove?s, Naim Te?rnava, i cili iu drejtua opinionit te? gjere? me mesazh urimi pe?r ke?te? feste? dhe theksoi se ke?to festa ngjallin ndjenje?n pe?r vepra te? mira.

Myftiu, duke be?re? te? ditur se populli i Kosove?s, pe?rmes agje?rimit dhe adhurimeve, si dhe me ndihmat e be?ra pe?r nevojtare? gjate? muajit te? Ramazanit, me mbi 15 mije? pako, kane? treguar se i qe?ndrojne? besnik fjale?s se? Allahut xh.sh.

Duke i ve?ne? nje? theks te? vec?ante? se islami e?shte? kundë?r c?do terrori dhe se terrorizmi nuk ka vend ne? fene? islame, Te?rnava u shpreh se shume? njere?z te? pafajshe?m ne?pe?r bote? jane? viktime te? kriminele?ve dhe ftoi qe? te? gjithë te? japin kontribut pe?r paqe dhe tolerance?, i cili e?shte? edhe mesazhi i feste?s se? Fite?r Bajramit.

“Rastet e fundit ne? Stamboll dhe Irak, por edhe mbre?me? ne? Medinen e ndric?uar, afe?r

varrit të Pejgamberit të asaj janë dëshmitë më të freskëta për të parë se çfarë mund të bëjnë kriminelët, ku përsuan shumë njerez të pafajshëm”, u shpreh Te'nava.

Te'nava duke bërë të ditur se e drejta e marrjes së shpirtit i takon vetëm Atij i cili e ka krijuar dhe e ka dhuruar shpirtin, u shpreh se “Kjo që po ndodhë kinse në emër të fesë islame nëpër botë, kjo assesi nuk ka të bëjë me islamin. Islami nuk urdhëron në dhunë, por në paqe dhe harmoni, solidaritet me jetë të përbashkët, ngase kështu na mëson Kur'ani, kështu na mëson Muhammedi a.s., i dërguari i fundit për njerezimin e mbare”.